

# TË JESH VULLNETAR ËSHTË VIRTYT



# JEMI TË NDRYSHËM, POR TË BARABARTË

ALBION (12), ERLINA (12), ELMIRA (10), PETRIT (9), KUJTIME (10)



**Në demokraci kemi të lirë dhe të barabartë, prandaj kemi të drejtë të shprehim mendimet tona lirshëm**

**Me shumë entuziazëm e pritëm këtë ditë, që të vinim në Punëtorinë e Demokracisë „Demos-ti“. E dinim që këtu do të mësonim shumë dhe do të argëtoheshim me aktivitete të ndryshme. Se çfarë kemi diskutuar dhe mësuar, e kemi shkruajtur në këtë artikull**

Liria dhe barazia, janë fjalë të cilat dëgjoen shpesh në jetën e përditshme. A thua vallë, kush na i mundëson këto elemente neve si popull? Demokracia është pikërisht forma e qeverisjes, në të cilën populli ka shumë të drejta të garantuara me ligj. Duke pasur parasysh edhe kuptimin e vetë fjalës demokraci, kuptojmë se ajo është udhëheqje e popullit.

Ani dhe Rina janë dy shokë, të cilët shpesh shikojnë dokumentarë të ndryshëm. Një ditë prej ditësh, ata ishin duke shikuar një dokumentar që kishte të bënte me demokracinë. Ata kuptuan që forma e parë e demokracisë është shfaqur në Athinë, në kryeqytetin e Greqisë, në vitin 507 para erës sonë. Rina u çudit shumë kur kuptoi se në atë kohë të drejtën e vendimmarrjes e kishin vetëm burrat e pasur, kurse gratë dhe skllëverit nuk e kishin këtë të drejtë. Ajo e dinte që në demokraci element themelor është barazia. Por, në vazhdim të dokumentarit, panë se ky fakt tanimë ka ndryshuar dhe i gjithë populli pa dallim feje, gjinie, race, etj., e ka të drejtën e vendimmarrjes në vendet demokra-

tike. Përveç kësaj, Ani dhe Rina e panë sesa ka rëndësi pjesëmarrja aktive e secilit qytetar. Prandaj, në fund kur përfundoi dokumentari, Ani i tha Rinës: „Hmm..! Tani e kuptuam se sa shumë kemi ndikim në vendin tonë, si dhe sa shumë të drejta i kemi në këtë formë të qeverisjes, e cila na jep neve liri dhe barazi. Por, përgjegjësia jonë është të mësojmë, të punojmë dhe të bashkëpunojmë sa më shumë me njëri-tjetrin.“ Ne si fëmijë, edhe pse të vegjël, kemi rol të madh në vendin tonë. Kështu pra, e kemi të siguruar të drejtën e shkollimit. Mësimi dhe angazhimi në detyrat shkollore dhe në shumë aktivitete të tjera, veçse na ndihmojnë që ta zhvillojmë shtetin dhe të jemi e ardhmja e tij.



**Ne jemi „Gazetarët e ardhshëm“. Shpresojmë shumë që prej këtij artikulli do të mësoni atë që e mësuar edhe ne gjatë diskutimit, për të mirat që na sjell demokracia**



Ligjet, rregulla të cilat qytetarët e përgjegjshëm i respektojnë dhe i zbatojnë



Vota e secilit ka peshë të madhe. Kjo e drejtë duhet të shfrytëzohet, sepse me votë mund të sjellim ndryshimin



Respekti për veten dhe të tjerët është element bazë i demokracisë. Prandaj, bëhuni edhe ju si ne, respektoni njëri-tjetrin



Punojmë dhe veprojmë së bashku, sepse të bashkuar mund ta ndriçojmë vendin ku jetojmë, por ndoshta edhe gjithë botën





Qytetarë aktiv janë të gjithë ata, të cilët kontribuojnë në vendin e tyre. Ne fëmijët mund të kontribuojmë duke pastruar ambientin nga mbeturinat, duke ndihmuar të moshuarit, etj.



## ZGJEDHIM SI TË JETOJMË

ALBA (12), ALBERT (11), YLLKA (10), ERBLIN (11)



**Sot mësuam për procesin zgjedhor. Meqë jemi gazetarë, do t'i ndajmë këto informata me të gjithë ju**

Sot u bëmë gazetarë. Këtu në „Demos-ti“ për herë të parë jemi duke e përjetuar ndjenjën se si është të jesh gazetarë. Mirëpo, pjesa që më së shumti po na pëlqen është fakti që jemi gazetarë të Kuvendit të Kosovës. Gjithashtu, jemi shumë të lumtur që kemi mësuar për

klasën për vizitë. Ne, gjithashtu votuam edhe në grupin e vogël këtu në „Demos-ti“. Votimi ynë kishte të bënte me stinën tonë të preferuar. Pra, ne sot e kuptuam se zgjedhim shumë shpesh. Megjithatë, e drejta jonë për të votuar në procesin zgjedhor, shfrytëzohet pasi të kemi arritur moshën 18 vjeçare.

Ne qytetarët e Kosovës votojmë në dy lloje zgjedhjesh. Janë zgjedhjet komunale, ku ne zgjedhim kryetarët e komunave përkatëse dhe asamblistët. Si dhe zgjedhjet qendrore, ku votojmë për përfaqësuesit shtetëror, të cilët punojnë në Kuvend.

Ne e kemi kuptuar rëndësinë që ka vota jonë. Kuptojeni edhe ju. Ajo që e dallon numrin 99 nga numri 100, është vetëm një numër më shumë. Vota e të gjithë neve mund të jetë numri magjik që e bën numrin 99 numër 100. Kjo nënkupton se ndryshimi është në duart tona. Le ta bëjmë ndryshimin duke qenë pjesë e vendimmarrjes.



**Ne zgjedhim profesionet që na pëlqejnë**

demokracinë. Mësuam se cili është roli ynë në demokraci dhe kuptuam se ne jemi ata, të cilët udhëheqim në demokraci. Këtë e bëjmë duke votuar. E pikërisht, procesi zgjedhor është tema që ka pasur grupi ynë. Në vizatimin tonë pak më lart, kemi paraqitur një qytetar, i cili ka zgjedhur profesionin e tij të preferuar. Mirëpo, zgjedhje të tilla bëjmë çdo ditë. Për shembull, edhe ne si klasë kemi votuar dhe kemi zgjedhur vendin ku dëshirojmë të shkojmë bashkë me



**Gazetarët e Kuvendit**

# LIGJI PËR KOMUNIKACION MBRON QYTETARËT

ELIONA (12), ENDRIT (11), AURELA (10), RIDVAN (10), BLERTA (8)

## Ligjet funksionojnë për ne qytetarët

Përsëritet, unë jam një „hero“ dhe mua më quajnë „Semafor“. Unë përbëhem prej tri ngjyrave e ato janë: ngjyra e kuqe, ngjyra e portokalltë dhe ngjyra e gjelbër. Secila nga këto ngjyra ka një domethënie, për të cilat do të flasim në vazhdim. Në këtë artikull, dua të sqarohem se pse e quajta veten hero!

Gjëja më e rëndësishme që ka një individ, është jeta e tij. Unë jam ai, i cili i mbron këta individë gjatë kohës sa ata kalojnë në rrugë. Në rast se ka shumë vetura të cilat qarkullojnë në rrugë, unë e ndez dritën e kuqe për këmbësorët. Kjo ngjyrë nënkupton që qytetarët duhet të ndalen. Ngjyra e portokalltë, paralajmëron qytetarët që të përgatiten për t'u nisur, si dhe ngjyra e gjelbër tregon që këmbësorët mund të lëvizin lirshëm. Këto shenja vlejnë edhe për veturat dhe automjetet

e tjera. Ndoshta e kuptuat rëndësinë time në jetën e qytetarëve.

Semaforët përdoren për rregullimin e komunikacionit dhe bëjnë pjesë në rregullat e komunikacionit. Këto rregulla duhet të respektohen dhe të zbatohen nga të gjithë qytetarët e një shteti. Rregullat e tilla ndryshe quhen ligje. Në Kosovë, ligjet miratohen me anë të votave të deputetëve. Deputetët janë përfaqësuesit tanë, të cilët japin kontributin e tyre, si të tillë, në Kuvendin e Kosovës.

Prandaj, Kuvendi është institucioni më i lartë i shtetit dhe është shumë i rëndësishëm për ne.

Besojmë se kemi dhënë mjaft arsye për të na kuptuar pse e theksuam aq shumë rëndësinë e ligjeve. Shpresojmë shumë që përmes këtij artikulli, edhe ju ta kuptoni ndjeshëm më shumë rëndësinë e ligjeve.



Kur ne e shohim shenjën „STOP“ ne duhet të ndalemi



Ne jemi qytetarë, të cilët i respektojmë ligjet





## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:  
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Rilindja“  
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V & VI  
Website: www.demos-ti.org Vendi: Keqekollë, Prishtinë